



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 29 pikat 5 e 8 të ligjit 10019 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 5 të udhëzimit nr. 2 datë 5 dhjetor 2020 “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”, KQZ pranon aplikime nga shtetas që mund të emërohen kryesisht nga KQZ në rast të mosplotësimit të numrit të nevojshëm të anëtarëve të KZAZ-ve për vendimarrje në linkun <http://bit.ly/3YIE0w5> ose të dërguara në adresën postare të KQZ-së, Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë.

KUSHTET PËR EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT DHE SEKRETARIT TË KZAZ-SË

Anëtar dhe Sekretar i KZAZ-së mund të emërohet kryesisht nga Komisioneri çdo shtetas që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- b) ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist;
- c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
- ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- d) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
- dh) nuk ka qënë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit;

PAPAJTUESHMËRITË ME DETYRËN E ANËTARIT DHE TË SEKRETARIT TË KZAZ-SË

Nuk mund të shprehin interes dhe as të emërohen kryesisht anëtarë dhe/ose sekretarë të KZAZ-së shtetasit që janë:

- a) deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b) kryetarë të bashkive;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
- ç) anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin shtetasit:

- a) Kërkesë për shprehje interesi për emërimin kryesisht si anëtar apo si sekretar në zonën zgjedhore/zonën e administrimit zgjedhor ku ka vendbanimin. Kërkesa paraqitet e nënshkruar dhe përmban edhe adresën e postës elektronike dhe numrin telefonik të kontaktit.
- b) Çertifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
- c) Kopje të noterizuar të diplomës së arsimit të lartë. Kërkesa për shprehje interesi për emërimin kryesisht sekretar të KZAZ-së duhet të shoqërohet me kopje të noterizuar të diplomës së arsimit juridik;
- ç) Deklarim të nënshkruar nga shtetasi, sipas [lidhjes nr.1 \(kliko për të shkarkuar\)](#), se:
 - Tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike;

- Pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
- Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
- Shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KZAZ-së nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike;

AFATI PËR TË APLIKUAR: 04.01.2023